



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 342 Prot.

Tiranë, më datë 28.07.2026

VENDIM

Nr. 236, datë 08.07.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, i ndryshuar, neni 38, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, si dhe bazuar në VKM - në Nr. 792/2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, i ndryshuar, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.07.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së **Z. Ardis Duka** për pajisje me Licencë individuale në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale në Zbatim (Z), në kategorinë (A) në nënkategoritë: Z/A/3, Z/A/4, Z/A/5, Z/A/7;
2. Mosmiratimin e kërkesës së **Z. Ardis Duka** për pajisje me Licencë individuale në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale në Zbatim (Z), në kategorinë (A) në nënkategoritë: Z/A/1, Z/A/2, Z/A/6, pasi nuk plotëson numrin e projekteve për këto nënkategori, sipas përcaktimeve të VKM - së nr. 792/2020, Kreu II/B, pika 2, gërma c;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Endri HAXHIU

